

VENDIM
Nr. 800, datë 12.10.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.431, DATË 26.6.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ‘ITALIA’,
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 4, të vendimit nr. 431, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Fondi prej 67 402 334 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga fondet e buxhetit të vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe